



Pranimar / Doretuar Prilidjen/Prodato Received/Delivety	28.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shk. e Filog. Approva	Sasia Kehena Quantity
SPAMSTOK	5439/2023		1/8



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.843/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.843/2023 të datës 14.06.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat me adresë rruga kundër masës disiplinore "Vërejtjes" me Nr.prot.44/2023 të datës 16.05.2023 të shqiptuar nga Zëvendësuesi i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.843/2023 e datës 14.06.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vërejtja me numër Nr.prot.44/2023 e datës 16.05.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit, nga Zëvendësuesi i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr.prot:236/2012 të datës 25.10.2012 në pozitën "Asistent në zyrën e Sekretarit" në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Zëvendësuesi i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës i ka shqiptuar masën

disiplinore "Vërejtje", me numër Nr.prot.44/2023 me datë 16.05.2023, me arsyetimin se: Me datë 28 Prill 2023 ka hyrë në zyrën e administratës në kohën kur në zyre nuk ka qenë Menaxherja e Burimeve Njerëzore dhe pa njoftim paraprak, pa leje dhe pa ndonjë autorizim ka marrë listën e pagave të muajit prill 2023 të stafit të SKSK-QS dhe e ka fotokopjuar. Po të njëjtë ditë Menaxherja e Burimeve Njerëzore i drejtohet përmes e-mailit duke e njoftuar se është vënë në dijeni që është marrë lista e pagave nga ai dhe se e njëjta duhet asgjësuar. Pas kësaj zhvillimit të ngjarjes të pranishëm në zyrën e administratës ishin Drejtori i Qendrës së Situatave dhe Zyrtari i Prokurimit Pasi është pranuar njoftimi për rastin, zëvendës Sekretari i Këshillit të Sigurisë ka ftuar në takim dhe Sekretari ka kërkuar nga që të mbaj shënime për mbarëvajtjen e takimit dhe të përpiloj një procesverbal. Po ashtu Sekretari ka kërkuar nga të përpiloj një raport në lidhje me rastin e komunikimit verbal me që është zhvilluar në zyrën e saj e në prani të kolegëve të lartcekur. Duke marrë parasysh që ka fotokopjuar listën e pagave pa njoftim paraprak, pa leje dhe pa autorizim, dhe duke marr parasysh që disa herë ka shfaqur sjellje jo korrekte dhe jo etike në raport me kolegët e institucionit, është vendosur të shqiptohet masa disiplinore vërejtje në raport të baraspeshuar me dëmin e shkaktuar.

Ankuesi, kundër masës disiplinore "Vërejtje" me Nr.prot.44/2023 të datës 16.05.2023, më datë 14.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4735/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 03.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4735/2023 të datës 14.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Prova shtesë të datës 23.06.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 12.06.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 12.06.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 15.06.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 12.06.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 12.06.2023; E-mail nga Simbnj për A.R. i datës 16.06.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 12.06.2023; E-mail nga A.R. për V.G. etj. i datës 12.06.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 15.06.2023; E-mail nga A.R. për F.I. i datës 16.06.2023; E-mail nga A.R. për F.I. i datës 19.06.2023; Raport Specialistik nga spitali Vendim masa disiplinore vërejtje me numër Nr.prot.44/2023 i datës 16.05.2023; E-mail nga F.I. për A.K. etj. i datës 05.05.2023; Deklaratë e A.R. e datës 05.05.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 04.05.2023; Procesverbal i datës 02.05.2023; E-mail nga V.G. për A.R. 03.05.2023; E-mail nga A.R. për V.G. etj. i datës 02.05.2023; E-mail nga A.R. për V.G. etj. i datës 02.05.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 02.05.2023; E-mail nga A.R. për V.G. etj. i datës 28.04.2023; E-mail nga A.R. për F.I. etj. i datës 28.04.2023; E-mail nga F.I. për V.G. i datës 28.04.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 28.04.2023; E-mail nga A.R. për V.G. etj. i datës

28.04.2023; E-mail nga V.G. për A.R. etj. i datës 28.04.2023; E-mail nga A.R. për F.I. i datës 28.04.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 28.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 23.06.2023; E-mail nga C.Z. për F.I. etj. i datës 23.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 03.07.2023; Akt Emërim me numër Nr.prot:236/2012 i datës 25.10.2012; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 10.01.2014; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 16.05.2023; E-mail nga V.G. për F.I. i datës 28.04.2023; E-mail nga F.I. për V.G. i datës 28.04.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 28.04.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 28.04.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 28.04.2023; E-mail nga A.R. për F.I. i datës 28.04.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 28.04.2023; E-mail nga A.R. për V.G. etj. i datës 02.05.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 02.05.2023; E-mail nga V.G. për F.I. i datës 03.05.2023; E-mail nga F.I. për V.G. i datës 03.05.2023; Raport lidhur me marrjen dhe fotokopjimin e listes së pagave nga A.R. dhe T.M. i datës 02.05.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 03.05.2023; E-mail nga A.R. për V.G. etj. i datës 02.05.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 02.05.2023; Procesverbal me numër Nr.41/2023 i datës 02.05.2023; E-mail nga S.B. për V.G. i datës 03.05.2023; E-mail nga V.G. për Sh.Sh. etj. i datës 03.05.2023; E-mail nga K.K. për V.G. i datës 03.05.2023; E-mail nga V.G. për Sh.Sh. etj. i datës 03.05.2023; E-mail nga Sh.Sh. për V.G. i datës 03.05.2023; E-mail nga F.I. për A.A. etj. i datës 03.05.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 04.05.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 05.05.2023; Deklaratë e A.R. e datës 05.05.2023; E-mail nga F.I. për A.K. etj. i datës 05.05.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 06.07.2022; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 06.07.2022; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 05.07.2022; E-mail nga A.R. për Government CERT ASHI i datës 04.07.2022; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 07.07.2022; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 06.07.2022; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 05.07.2022; E-mail nga A.R. për Government CERT ASHI i datës 04.07.2022; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 13.07.2022; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 26.08.2022; E-mail nga B.H. për V.G. i datës 26.08.2022; E-mail nga A.R. për B.H. i datës 26.08.2022; E-mail nga V.G. për A.R. etj. i datës 16.11.2022; E-mail nga A.R. për A.C. i datës 15.11.2022; E-mail nga A.C. për B.P. etj. i datës 15.11.2022; E-mail nga B.P. për Sh.Sh. etj. i datës 15.11.2022; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 16.03.2023; E-mail nga A.R. për F.I. etj. i datës 15.03.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 15.03.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 15.03.2023; E-mail nga F.I. për V.G. i datës 15.03.2023; E-mail nga A.R. për A.R. etj. i datës 15.03.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 15.03.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 13.03.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 15.06.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 12.06.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 12.06.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 12.06.2023; E-mail nga A.R. për V.G. i datës 12.06.2023; Vendim për pushim i A.R. i datës 15.06.2023; E-mail nga F.I. për A.R. i datës 16.06.2023; E-mail nga A.R. për F.I. i datës 16.06.2023; E-mail nga A.R. për F.I. i datës 19.06.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 15.06.2023; E-mail nga V.G. për A.R. i datës 12.06.2023; E-mail nga F.I. për C.Z. i datës 03.07.2023; Autorizim nga A.R. për Zyren Ligjore ABOivier dhe Associates e muajit Korrik 2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar,**
sepse:

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, ku i njëjti ka deklaruar se masën disiplinore vërejtje e kundërshton në tërësi si të paligjshme për faktin se nuk janë plotësuar elementet e përgjegjësisë disiplinore në rastin konkret komfor nenit 45 të Ligjit për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se nga fotokopjimi i listës së pagave nuk është shkaktuar asnjë dëm dhe as

nuk është keqpërdorur lista e pagave këtë e dëshmon edhe deklarata e datës 05.05.2023 e nënshkruar nga unë të cilën ia kam dërguar zyrtares së Personelit dhe ajo më pas zv. Sekretarit të KSK-së Po ashtu i njëjti thekson faktin se deri me datë 05.05.2023 fotokopjimi i listës së pagave nuk ka qenë i ndaluar dhe as nuk kam qenë i informuar se është i ndaluar fotokopjimi i listës së pagave. Ndërsa me datë 05.05.2023 është nxjerrë njoftimi nga punëdhënësi ku thuhet se: *Me kërkesën e zv. Sekretarit të KSK-së njoftoheni që nënshkrimi i listave të pagave do të bëhet vetëm në prezencën time dhe se mundësia e nënshkrimit të listës do të jetë pesë (5) ditë pune nga data e njoftimit për nënshkrim. Po ashtu njoftoheni se nuk lejohet marrja e listës së pagave pa autorizim, dhe për çdo shmangie nga ky rregull do të njoftohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejte ku do të merren masa sipas legjislacionit në fuqi.* Ankuesi po ashtu thekson faktin se lista ka qenë në zyrën e përbashkët në tavolinën e takimeve ku prezent ka qenë zyrtari i buxhetit pra listën e kam marrë për të fotokopjuar se më është dashur, por jo se nuk ka qenë prezent zyrtarja e personelit në zyre dhe se zyrja nuk ka qenë vetëm dhe pas kërkesës së zv. Sekretarit listën e pagave e kam dorëzuar pa asnjë problem tek zyrtarja e personelit i njëjti kërkon nga Këshilli që ti aprovohet në tërësi ankesa dhe të anulohet masa disiplinore vërejtja me numër Nr.44/2023 i datës 16.05.2023.

Ndaj ankuesit është nxjerrë Raport lidhur me marrjen dhe fotokopjimin e listës së pagave, nga Menaxherja e Personelit në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës me datë 02.05.2023. Po ashtu në shkresat e lëndës është evidentuar se personat të cilët kanë qenë të pranishëm kur ka ndodhur rasti, kanë dërguar Raport për ngjarjen e datës 28 Prill 2023 ku përmes e-mailit me datë 03.05.2023 i është drejtuar Zëvendësuesit të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës se citoj: *I nderuar Sekretar Unë i konfirmoj faktet e cekura në këtë raport bashkangjitur për atë çfarë ka ndodhur dhe çfarë është thënë atë ditë për pjesën sa kam qenë në zyre.* përmes e-mailit me datë 03.05.2023 i është drejtuar Zëvendësuesit të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës se citoj: *I nderuar Sekretar Unë i konfirmoj faktet e cekura në këtë raport të bashkangjitur Me respekt!* përmes e-mailit me datë 03.05.2023 i është drejtuar Zëvendësuesit të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës se citoj: *Të nderuar Unë kam qenë dëshmitar kur zhvillon një komunikim aspak kolegial me Menaxheren e Personelit dhe se pajtohem plotësisht me faktet e listuara në procesverbalin e hartuar nga Menaxhere e Personelit.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar "Vërejtjen" me numër Nr.prot.44/2023 të datës 16.05.2023 të shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ndaj ankuesit ku përcaktohet se citoj: *Me datë 28 Prill 2023 ka hyrë në zyrën e administratës në kohën kur në zyre nuk ka qenë Menaxherja e Burimeve Njerëzore dhe pa njoftim paraprak, pa leje dhe pa ndonjë autorizim ka marrë listën e pagave të muajit prill 2023 të stafit të SKSK-QS dhe e ka fotokopjuar. Po të njëjtë ditë Menaxherja e Burimeve Njerëzore i drejtohet përmes e-mailit duke e njoftuar se është vënë në dijeni që është marrë lista e pagave nga ai dhe se e njëjta duhet asgjësuar. Pas kësaj i shkon dy herë në zyre duke iu drejtuar me ton të ngritur e gjuhë kërcënuese. Gjatë zhvillimit të ngjarjes të pranishëm në zyrën e administratës ishin Drejtori i Qendrës së Situatave Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari i Prokurimit z. Pasi është pranuar njoftimi për rastin, zëvendës Sekretari i Këshillit të Sigurisë ka ftuar në takim dhe Sekretari ka kërkuar nga të mbaj shënime për mbarëvajtjen e takimit dhe të përpiloj një procesverbal. Po ashtu zv. Sekretari ka kërkuar nga të përpiloj një raport në lidhje rastin e komunikimit verbal me të njëjtën zyrtare dhe të shprehë mendimet e saj për të. Pasi është zhvilluar në zyrën e saj e në prani të kolegëve të lartcekur. Duke marrë parasysh që ka fotokopjuar listën e pagave pa*

njoftim paraprak, pa leje dhe pa autorizim, dhe duke marr parasysh që disa herë ka shfaqur sjellje jo korrekte dhe jo etike në raport me kolegët e institucionit, është vendosur të shqiptohet masa disiplinore vërejtje në raport të baraspeshuar me dëmin e shkaktuar.

Ankuesi me datë 05.05.2023 ka bërë Deklaratë në të cilën potencon citoj: Unë deklaroj se listën e fotokopjuar të pagave të stafit të SKSK-QS e kam kthyer dhe se nuk kam ndalur ndonjë kopje tjetër të saj. Po ashtu se të dhënat personale të zyrtarëve që janë pjesë e listës nuk do të keqpërdoren nga ana ime për ndonjë qëllim të caktuar.

Ndaj ankuesit, Zëvendësuesi i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" duke u bazuar në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 dhe 4.4, nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik, në pajtim me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik si dhe në pajtim me nenin 11, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me Vërejtjen e shqiptuar Kolegji ju referua Ligjit Nr.06/L-82 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjegjësisht nenit 2 paragrafi 1 ku përcaktohet se "Fushëveprimi 1. Ky ligj zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga organet publike dhe private. Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nëse përpunimi kryhet për qëllime krejtësisht personale, nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 E dhënë personale - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik", si dhe nenit 4 paragrafit 1 ku përcaktohet se "Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës - të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të dhënave".

Kolegji i Këshillit duke ju referuar dispozitave të lartshënuara të Ligjit Nr.06/L-82 për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe duke u ndërlidhur me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45 me të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenit 46 me të cilin është përcaktuar se: "... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi

i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Nenit 47 paragrafit 1 më të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.

Nenit 48 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore “1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.

Nenit 50 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar se: “1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”, konstaton se ekziston lidhja shkakësore e ankuesit për përgjegjësin disiplinore, sepse pa asnjë lloj autorizimi, pa pasur përshkrim të punës një gjë të tillë dhe pa dijeninë e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore ka marr listën e pagave e cila përmban të dhëna personale të punësuarve në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, prandaj me këtë veprim ankuesi ka ra në kundërshtim me dispozitat e lartshënuar të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit po ashtu i’u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 25 paragrafi 1, 2 dhe 3, i cili ka përcaktuar se: 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike.

Kolegji i Këshillit, ka vlerësuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit për rastin konkret me rastin e ndërmarrjes së veprimeve ligjore lidhur me shqiptimin masës disiplinore “Vërejtjes” me numër Nr.prot.44/2023 të datës 16.05.2023 ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, në të cilin

përcaktohet se: "2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", e po ashtu edhe në pajtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilën përcaktohet se: "2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafin 4, nën paragrafin 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit..... 4.4. si dhe neni 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafi 2 dhe 4 ku përcaktohet se: 1. Kompetent për shqiptimin e masave disiplinore sipas kësaj Rregullore janë: 1.1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë shqipton masën disiplinore të përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit. 4. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit dhe rrjedhimisht edhe pretendimet ankimore të tij në këtë kontekst janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me objektin e ankesës së ankuesit, ka konstatuar se Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë në rastin konkret "Zëvendësuesi i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës", në kuadër të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ka arritur të konstatoj saktë gjendjen faktike dhe juridike në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" dhe ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili thekson se: "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, sepse bazuar në konstatimet e mësipërme janë vërtetuar saktë veprimet e paligjshme të ankuesit lidhur me çështjen në fjalë sipas elaborimit më lartë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.843/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit.*
- *Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*